



BASHKIA  
TIRANË  
R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 68, datë 12.06.2020

**“PËR  
MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR TRE  
ZONA TË QYTETIT TË TIRANËS, PËR INDIVIDËT/FAMILJET QË NUK MUND TË  
PËRBALLOJNË PAGESËN E QIRASË NË TREGUN E LIRË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 38, pika 1, të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 33, datë 29.03.2018, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e tre lagjeve të reja në Bashkinë Tiranë”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për tre zona të qytetit të Tiranës, për individët/familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale, sipas vlerave të mëposhtme:
  - a. Zona A: 33.619 (tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë
  - b. Zona B: 25.062 (njëzet e pesë mijë e gjashtëdhjetë e dy)lekë
  - c. Zona C: 19.800 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind)lekë
2. Ndarja e zonave përcaktohet sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca nr. 1.
3. Vendimi nr. 15, datë 02.05.2012, i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të bonusit të strehimit për tre zona të qytetit të Tiranës për familjet në nevojë për strehim”, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU

Konceptoi  
E.Demiraj